



# MEMORANDUM MIRËKUPITIMI

ndërmjet


MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministri i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministri i Brendshëm i Republikës së Shqipërisë nisur nga interesi reciprok për bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve që përfaqësojnë, si dhe me qëllim zgjerimin e marrëdhënieve dypalëshe, ranë dakort si më poshtë:

- Të vazhdohet dhe të thellohet bashkëpunimi ndërmjet policive të të dy shteteve për parandalim të efektshëm dhe për një luftë ndaj krimit në përgjithësi, krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të drogave dhe lëndëve psikotrope, trafikut të qënieve njerëzore dhe pastrimit të parave. Një bashkëpunim i tillë duhet të jetë pjesë e aktiviteteve të zakonshme intensive institucionale për secilën nga administratat kompetente të të dy ministrive;
- Të bashkëpunohet ngushtë në fushën e emergjencave civile duke bërë të gjitha përgatitjet për nënshkrim sa më shpejt të një protokollit të veçantë bashkëpunimi institucional dhe operacional në fushën e emergjencave civile;
- Të bashkëpunohet ngushtë në fushën e dokumentacionit civil për qytetarët e të dy shteteve në formën e shkëmbimit të informacionit dhe eksperiencës në fushën e mbajtjes së të dhënave për qytetarët si dhe pajisjen e tyre me dokumenta civile;
- Të inkurajohet vendosja e kontakteve të vazhdueshme teknike dhe të punës ndërmjet zyrtarëve partnerë të të dy ministrive;
- Secila palë duhet të caktojë personin kontaktues të atashuar pranë secilës Ministri, i cili duhet të autorizohet të marrë, të sigurojë dhe të përcjellë informacionin si dhe të dorëzojë dhe të marrë kërkesat për bashkëpunim;
- Në frymën e këtij memorandumi dhe të marrëveshjeve të mëparshme të themelohet Komisioni i Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë me qëllim hartimin e protokolleve përkatëse në fushat e kompetencës së të dy ministrive me fokus të veçantë në fushën e emergjencave civile dhe të dokumentacionit civil dhe të përditësimit dhe operacionalizimit të marrëveshjeve në fuqi ndërmjet të dy ministrive në fushat e kompetencës së të dy Ministrive të Brendshme;



- Secila Ministri emëron Bashkëdrejtuesin e Komisionit të Përbashkët, i cili udhëheq delegacionin përkatës në takimet e Komisionit të Përbashkët;
- Në takimin e parë të Komisionit të Përbashkët, do të përcaktohet rregullorja e punës së këtij Komisioni si dhe krijimi i Nën- Komisioneve të përbashkëta sipas fushave të veçanta të bashkëpunimit;
- Data e takimit të parë të Komisionit të Përbashkët dhe axhenda e tij do të vendoset me marrëveshje ndërmjet të dy Ministrave të Brendshëm pas propozimeve që do të vijnë nga personat e kontaktit;
- Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi menjëherë dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Zenun PAJAZITI  
Ministër i Punëve të Brendshme  
të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 25 shtator 2008

Bujar NISHANI  
Ministër i Brendshëm  
i Republikës së Shqipërisë

Prishtinë, 25 shtator 2008